

UDHËZUES MBI NISMAT QYTETARE NË QEVERISJEN LOKALE



Autor: Megi Bejtja
 Ivi Bejtja

Ky manual u përgatit nga autorët me mbështetjen e Fondacionit Konrad Adenauer në kuadër të projektit “Iniciativat qytetare si mjet për përmirësimin e demokracisë dhe mirëqeverisjes”. Përmbajtja e këtij materiali është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer.

© Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi, mbrojtur nga ligji nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me to”, nuk mund të riprodhohet, ruhet, transmetohet a përdoret me asnjë formë e mjet grafik, elektronik apo mekanik, përfshirë por jo kufizuar fotokopje, skanime, digjitalizim, rrjet ueb apo sisteme të tjera pa lejen me shkrim të botuesve.

Përmbajtja

1. E drejta e qytetarëve për pjesëmarrjen në vendimmarrjen	6
1.1 Nismat ligjore qytetare	6
1.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal	7
1.2.1 Iniciativa qytetare në nivelin lokal	7
1.2.2 Referendumet vendore	7
1.2.3 Peticionet	8
1.2.4 Ankesat dhe vërejtjet	8
2. Burimet e së drejtës së iniciativave qytetare në nivelin lokal	9
2.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë	9
2.2 Ligji për vetëqeverisjen vendore	9
3. Institucionet vendore, klasifikimi dhe roli i tyre në iniciativat qytetare	12
3.1 Roli i bashkisë në iniciativat qytetare	13
3.2 Roli i qarkut tek iniciativat qytetare	13
4. Procedura për nismat qytetare pranë bashkive të vendit	15
4.1 Hapat e parë për iniciativën qytetare	16
Model peticioni për iniciativë qytetare drejtuar këshillit bashkiak	20
4.2 Mbledhja e nënshkrimeve	22
4.3 Afati i mbledhjes së nënshkrimeve	23
4.4 Vendi i mbledhjes së nënshkrimeve	24
4.5 Dorëzimi i nënshkrimeve dhe iniciativës pranë këshillit bashkiak	24
4.6 Shqyrtimi i iniciativës në mbledhjen e këshillit	27
5. Rregulla për hartimin e nisme vendore	28
5.1 Parimet e hartimit të një nisme	28
5.1.1 Parimi i ligshmërisë	28
5.1.2 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit	28
5.1.3 Parimi i domosdoshmërisë	29
5.1.4 Parimi i efektivitetit	29
5.1.5 Parimi i qartësisë	29
5.1.6 Parimi i ekonomisë së tekstit	29
5.2 Gjuha e përdorur	29
5.3 Hapat e parë për formulimin e hartimin e një nisme	31
5.3.1 Vlerësimi dhe kostoja e iniciativës	31
5.3.2 Titulli dhe preambula	32
5.4 Dokumentet plotësuese krahas iniciativës qytetare	32
5.4.1 Relacioni	32
5.4.2 Efektet financiare	33
5.5 Rregulla për hartimin e ndryshimeve	33
6. Përfundime dhe rekomandime	35
<i>Bibliografia</i>	36

Për lexuesin!

Kushtetuta është ligji themeltar i çdo shteti. Ajo vendos regulla dhe parime të përgjithshme për organizimin e shoqërisë. Në kushtetutën e Republikës së Shqipërisë përcaktohet se “pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”. Kushtetuta ka krijuar institucione shtetërore ku për qëllim kanë garantimin e të drejtave dhe interesin më të lartë të qytetarëve.

Pavarësisht ekzistencës së këtyre institucioneve, ato nuk arrijnë të përmbushin plotësisht interesat e publikut. Për të plotësuar mangësitë e vëmëndjes të shtetit ndaj qytetarëve, kushtetuta parashikon disa mekanizma të tjera për të garantuar interesat e qytetarëve. Ajo i mundëson qytetarëve pjesëmarrjen në mënyrë të drejtpërdrejtë në proceset vendimmarrëse. Ndër to përmendim nismën ligjvënëse qytetare (neni 81.1 i Kushtetutës) dhe referendumit shfuqizues (neni 150.1 i Kushtetutës dhe peticionet drejtuar organeve publike (neni 48 i Kushtetutës) .

Në botimin e mëparshëm “Udhëzues mbi nismat ligjvënëse qytetare” të mbështetur nga fondacioni Konrad Adenauer Stiftung janë paraqitur në mënyrë të detajuar hapat e nevojshme për realizimin e të drejtave të qytetarëve për iniciativë ligjvënëse drejt Parlamentit.

Megjithatë edhe pse nismat e këtij niveli janë mjaft të rëndësishme, ato do të mbeteshin të paplotësuara në rast se nuk do të trajtohej edhe e drejta për nisma në qytetet ku ata banojnë. Duhet të kemi parasysh se shumë problematika të cilat hasen në përditshmëri, qytetarët nuk mund ta zgjidhin nëpërmjet përfaqësuesve në Parlament apo përmes një projekt iniciative, por nga qeverisja vendore, pra Bashkitë.

Prandaj ky udhëzues është hartuar për ti ardhur në ndihmë dhe fuqizuar kapacitetet të gjithë qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile, në mënyrë që të ndër marrin nisma drejt bashkive të vendit, si aktorë të patjetërsueshëm për garantimin e të drejtave të tyre. Përmes tij synohet të shpjegohet cilat janë llojet e nismave në nivelin lokal, si mund të realizohet një nismë e tillë dhe cilat janë hapat të cilat qytetarët do të ndërmarrin për të përmbushur me sukses nismat qytetare në qytetet që ata banojnë.

E drejta e qytetarëve për pjesmarrjen në vendimarrjen

Kushtetuta e Shqipërisë parashikon disa mënyra në të cilat qytetarët mund të bëhen aktivë. Nëse përfaqësuesit e zgjedhur me votën e qytetarëve nuk i shërbejnë interesave dhe nuk respektojnë të drejtat e tyre, Kushtetuta ofron mekanizma të veçantë për rikthimin e tyre, duke i bërë qytetarët aktorë kryesorë në procesin vendimmarrës.

1.1 Nismat ligjore qytetare

Të drejtën për të propozuar ligje e kanë jo vetëm Këshilli i Ministrave apo deputetët, por edhe qytetarët. Ligjet e propozuara nga të paktën 20 mijë qytetarë quhet nismë ligjore qytetare¹. Ky mjet (nismat qytetare) i shërben demokracisë dhe shtetit të së drejtës, në dy aspekte kryesore:

- i. Përfshirja e drejtpërdrejtë e qytetarëve në proceset ligjvënëse është një mjet demokratik dhe transparent. Kjo qasje promovon një mënyrë të hapur të marrjes së vendimeve, duke lejuar qytetarët të kenë një rol aktiv dhe të ndikojnë në zhvillimin e legjislacionit. Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në proceset ligjvënëse sjell një ndjenjë të fortë përgjegjësie qytetare, pasi ata kanë mundësinë të kontribuojnë në përcaktimin e rregullave dhe ligjeve që do t'u nënshtrohen shoqërisë. Këtë rrugë demokratike e karakterizon transparenca, pasi në proces përfshihen vetë qytetarët dhe mund të shihet dhe vlerësohet nga të gjithë. Ky fakt do të ndihmojë krijimin e një mjedisi ku vendimet janë të një rëndësie të vecante pasi ato do të jenë në përputhje me nevojat dhe vullnetin e komunitetit.
- ii. Përmes nismave ligjore, qytetarët shprehen dhe përcjellin çështjet që i prekin më shumë. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve krijon një kanal të drejtpërdrejtë komunikimi me institucionet ligjvënëse dhe forcon demokracinë përmes rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë. Në këtë mënyrë, nismat ligjore paraqesin një mekanizëm të rëndësishëm për të thelluar pjesëmarrjen demokratike dhe për të siguruar që procesi i hartimit të ligjeve të reflektojë më mirë nevojat dhe shqetësimet e përditshme të qytetarëve.

Për të hartuar një nismë ligjore duhet të plotësohen 2 kushte kryesore:

- i. Të nënshkruhet nga 20 mijë zgjedhës. Zgjedhës është çdo qytetar i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka shtetësi shqiptare. Personat të cilët

¹ Neni 81 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

- i. përjashtohen nga kjo e drejtë janë ata, të cilëve ju është hequr zotësia për të vepruar² ose që me iniciativëiu është hequr kjo e drejtë³. Nga kjo e drejtë përfitojnë dhe personat të cilët janë dënuar dhe janë duke vuajtur dënimin në një nga burgjet e vendit.
- ii. Të plotësojë kriteret formale dhe materiale në hartimin e një projektligji. Rregullorja e Kuvendit parashikon disa kriteret të cilat duhet të plotësojë projektligji. Ai duhet të hartohet në formën e një akti normativ dhe duhet të përmbajë një relacion ku të shpjegojë objektivin e tij, ndikimin që do të ketë në shoqëri si dhe përputhshmërinë tij me Kushtetutën dhe legjisllacionin e BE-së⁴.

1.2 Pjesëmarrja e qytetarëve në nivel lokal

Pjesëmarrja e qytetarëve aktivë të cilët kërkojnë të përfshihen në vendimmarrje në nivel lokal është një element thelbësor i një demokracie të shëndetshme. Qytetarët mund të marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në vendimmarrjet e qeverisjes lokale, në problematikat që kanë për qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve. Ata mund të përdorin disa nga mjetet e mëposhtëme për të qënë pjesë aktive e vendimmarrjes:

1.2.1 Iniciativa qytetare në nivelin lokal

Iniciativa qytetare ndërmerren nga jo më pak se një përqind e qytetarëve pranë një bashkie, e cila ka për qëllim tu japi mundësi këtyre të fundit të paraqesin problematika me të cilat hasen në përditshmëri.

1.2.2 Referendumet vendore

Referendumet vendore është formë e shprehjes së demokracisë me pjesmarrje të drejtpërdrejtë në qeverisjen vendore ku nëpërmjet pjesëmarrjes së qytetarëve vendoset për çështje me rëndësi për komunitetin⁵. Nismën për një referendum vendor, për një çështje të qeverisjes vendore, mund ta ushtrojnë:

² Zotësia për të vepruar është aftësia për të kryer veprime të ndryshme juridike.

³ Neni 45 pika 3 e Kushtetutës

⁴ Për më shumë shih Udhëzuesin Për Nismat Ligjvënëse Qytetare <https://www.kas.de/documents/271859/271908/Udhezues+mbi+nismat+ligjvënese+qytetare.pdf/ceac5c05-a445-afaf-e9bb-8c972fcf5a53?version=1.0&t=1639045327422>

⁵ Për më shumë shih: <https://portavendore.al/hyrnebashki/referendumet-vendore/>

a) 10 për qind e zgjedhësve, të regjistruar në listat e zgjedhësve të njësisë vendore përkatëse ose 20 mijë prej tyre, cilado shifër më e vogël.

b) Një numër këshillash bashkiakë, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën e popullsisë së një qarku, kanë të drejtë të kërkojnë zhvillimin e një referendumi për një çështje të qeverisjes vendore në nivel qarku.

Referendumi vendor mund të mbahet për një çështje të qeverisjes vendore që njëherazi është edhe çështje e rëndësisë së veçantë.

1.2.3 Peticionet

Peticioni është një mekanizëm i demokracisë pjesëmarrëse pasi inicohet nga publiku, në dallim me informimin dhe konsultimin publik që janë detyra të bashkisë.

E drejta e peticionit është e parashikuar në kapitullin e lirive politike në nenin 48 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet se kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t'u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.

Çdo person apo organizatë me interes në një bashki të caktuar ka të drejtën e hartimit dhe nënshkrimit të peticionit drejtuar Këshillit Bashkiak për çdo çështje që lidhet me përgjegjësitë dhe kompetencat e bashkisë. Pas pranimit të peticionit, Këshilli Bashkiak shqyrton atë duke respektuar procedurat dhe afatet e përcaktuara në rregulloren e tij të punës.

1.2.4 Ankesat dhe vërejtjet

Ligji për vetëqeverisjen vendore i jep të drejtën çdo qytetari apo grupi qytetarësh që përfaqësojnë komunitetet lokale t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore⁶.

⁶ Neni 19 i ligji "Për qeverisjen vendore" "Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë t'u drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje organeve të vetëqeverisjes vendore për çështje që lidhen me funksione dhe kompetenca në juridiksionin e njësisë së vetë-qeverisjes vendore."

2

Burimet e së drejtës së iniciativave qytetare në nivelin lokal

Burimet e së drejtës parashikohen në Kushtetutë dhe në ligje. Ato janë të rëndësishme për të përcaktuar hierarkinë e kuadrit ligjor në vend . Përsa i përket pushtetit lokal, kushtetuta parashikon së aktet e organeve të qeverisjes lokale kanë fuqi juridike vetëm në hapësirën territoriale që ushtrojnë funksionin e tyre . Renditja e burimeve kryesore për iniciativat qytetare është si më poshtë.

2.1 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk saktëson shprehimisht të drejtën e qytetarëve për të iniciuar nisma drejt bashkive, por kjo e drejtë del nga interpretimi i nenit 48 të saj, i cili thotë: *“Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë, mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj.”*

Në interpretimin thelbësor tëë dispozitës kushtetue, e drejta për të drejtuar kërkesa drejt organeve shtetërore shihet si hapësirë brenda së cilës synohet zgjidhja e një problematike të caktuar.

Vlen të theksohet se pjesa e Parimeve Themelore të Kushtetutës nuk i është nënshtruar ndryshimeve që prej miratimit të saj. Kështu koncepti i nismave qytetare në kohën e miratimit të Kushtetutës ishte ende i panjohur, duke qënë se Shqipëria sapo kishte dalë nga regjimi diktatorial.

2.2 Ligji për vetëqeverisjen vendore

Rregullimi ligjor i iniciativave qytetare në qeverisjen vendore zakonisht është parashikuar në ligjin themeltar për vetëqeverisjen vendore. Ai përcakton strukturën, kompetencat dhe procedurat të cilat aplikohen në rradhët e qeverisjes lokale. Megjithatë koncepti i nismave qytetare në Shqipëri është një koncept i parashikuar vonë në ligjin për vetëqeverisjen vendore.

Ligji Nr.7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, ishte ligji i parë për vetëqeverisjen vendore në Shqipëri. Ai bazohej në parimet e Ligjit

⁷Neni 116, pika 1 e Kushtetutës.

⁸Neni 116, pika 2 e Kushtetutës.

Ai bazohej në parimet e vetqeverisjes, autonominë lokale, ligjshmërisë dhe zgjedhshmërisë⁹. Ky ligj reformoi qeverisjen lokale dhe zëvendësoi mënyrën e organizimit të strukturave të qeverisjes lokale të Ligji nr.6068, datë 24.12.1979 "Për këshillat popullorë", i cili në çdo dimension ishte ndryshe dhe se i përkiste një epoke tjetër të shoqërisë shqiptare. Duke filluar nga zgjedhjet, ku kryetarët e bashkive, kryetarët e komunave dhe këshillat lokal zgjidheshin një herë në katër vite nga votuesit.

Ligji i ri, synonte të krijonte autoritete lokale me autonomi efektive ndaj pushtetit qendror. Në fakt autoritetet lokale kishin një autonomi të kufizuar dhe nuk arritën asnjëherë të ishin të pavarura nga vendimet e qeverisë qendrore. Bazuar në ligj, autoritetet lokale kishin një autonomi financiare të cilat lirisht mund të zhvillonin dhe zbatonin politika të veçanta financiare. Megjithatë, mbështetja me e madhe buxhetore vinte nga fondet të cilat alokoheshin nga qeveria qendrore. Kjo vinte si rrjedhojë e mungesës së mbledhjes së të ardhurave nga qeverisja lokale.

Ky ligj nuk arriti të parashikojë asnjë dispozitë për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje në mënyrë të drejtpërdrejtë, por i mundësonte atyre votimin në referendume për çështje të një rëndësie të vecantë¹⁰. Referendumet rregulloheshin me ligj vecantë. Duke marrë parasysh që ky ligj është miratuar dy vite pas rënies së regjimit diktatorial, është mëse e kuptueshme se koncepti i përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje të mos jetë i pranishëm në ligj.

Në vitin 2000 Kuvendi miratoi ligjin Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore". Ai zëvendësoi ligjin e mëparshëm duke sjellë disa risi. Ky ligj ishte pikënisje për sa i përket rolit të qytetarëve dhe organizatave jofitimprurëse në përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse, transparencës dhe llogaridhënies të pushtetit vendor.

Fillimisht, bashkitë dhe komunat do të parashikonin zëra në buxhetet e tyre, për dhënien e informacioneve për funksionet dhe kompetencat e ushtruara nga njësia qeverisjes vendore. Të drejtën e informimit të qytetarëve, ligji e parashikonte si mënyrë e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje¹¹.

Këshilli komunal dhe ai bashkiak ndërmerrnin seanca këshillimi të hapura me banorët, organizata jofitimprurëse dhe specialistë¹² për tema të cilat kishin në fokus miratim e buxheteve, tjetërsimin dhe dhënien në përdorim të pronave¹³.

⁹ Neni 1, Iniciativënr.7572, datë 10.06.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal"

¹⁰ Neni 4, Iniciativënr.7572, datë 10.06.1992 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal"

¹¹ Neni 19, i Ligj Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"

¹² Neni 35, Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"

¹³ Neni 32, Nr.8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore"

Ndonëse ende nuk parashikohet shprehimisht e drejta e iniciativës qytetare, kjo dispozitë për herë të parë i lejon qytetarët që në një mënyrë të bëheshin pjesë e vendimmarrjes.

Në vitin 2004, përmes disa amendimeve ligjore parashikohet pjesmarrja e qytetarëve në vendimmarrjen e këshillit bashkiak dhe komunal. Konkretisht në nenin 45 të ligjit parashikohet se kryesia e fshatit merr nisma për probleme të ndryshme për interesin e komunitetit, të cilat ia propozon për shqyrtim këshillit komunal dhe bashkiak.

Së fundmi, pas reformës territoriale kuvendi miratoi edhe reformën për qeverisjen vendore nëpërmjet Ligj Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”. Në përbërje të tij u sanksionua për herë të parë shprehimisht e drejta e qytetarëve për kërkesa, ankesa, vërejtje¹⁴ dhe iniciativë qytetare. Ligji ka disa risi pozitive për vendosjen e demokracisë funksionale dhe përfshirjen e drejtëpërdrejtë të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Të drejtën për iniciativë qytetare e kanë qytetarët e bashkise respektive, organizatat jo qeveritare si dhe cdo grup interesi. Ato i paraqesin këshillave bashkiakë iniciativat të cilat janë brenda juridiksionit të bashkisë. Propozimet nga iniciativat qytetare me ndikimi në buxhetin e bashkisë shqyrtohen në këshillin bashkiak duke marrë edhe mendimin e kryetarit të bashkisë¹⁵.

E drejta iniciativave qytetare është parashikuar si një e drejtë e cila nga mënyra, procedura deri në miratimin e tyre, duhet të përcaktohen në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak.

Këshillat Bashkiak kanë miratuar rregulloret e funksionimeve dhe organizimeve të këshillave të tyre. Vihet re se shumë pak bashki kanë parashikuar të drejtën e iniciativave qytetare në mënyrën e përcaktuar nga ligji. Për të përmbushur detyrimin ligjor, bashkitë të cilat nuk e kanë pjesë integrale të rregullores për këshillin bashkiak e kanë miratuar nëpërmjet një rregulloreje të vecantë. Iniciativa për krijimin e rregullores së vecantë të këshillave bashkiak erdhi si zbatim i nismës së disa organizatave jo qeveritare dhe partnerë ndërkombëtarë të cilët kanë në fokus zhvillimin e pushtetit vendor dhe forcimin e qytetarëve në proceset vendimmarrëse të qeverisjes vendore¹⁶.

¹⁴Neni 19, Ligj Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

¹⁵Neni 20, Ligj Nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

¹⁶Pas miratimit të Ligjit për Vetqeverisjen Vendore, ka pasur përpjekje për të përmirësuar dhe ndryshuar rregullimet për nismat qytetare në varësi të përvojës dhe nevojave lokale. Kjo ka përfshirë rritjen e transparencës, lehtësimin e procedurave për nismat qytetare dhe përmirësimin e mekanizmave për monitorimin dhe vlerësimin e tyre. Në vitin 2016 përmes projektit “Bashki të Forta” të Qeverisë Zvicerane i zbatuar nga HELVETAS Bashkëpunimi Zviceran (HSI), ndihmoi bashkitë e vendit për të hartuar rregullore të posaçme për nismat qytetare.

Institucionet vendore, klasifikimi dhe roli i tyre në Iniciativat qytetare

KSH parashikon se institucionet vendore janë komunat ose bashkitë dhe qarqet¹⁷. Ndërkohë Ligji 135/2015 përcakton si intitucione të qeverive vendore bashkitë dhe qarqet¹⁸.

Kuvendi miratoi reformën administrative në vitin 2015. Ajo hoqi nga ndarja administrative komunat dhe la vetëm bashkitë dhe qarqet. Mirëpo kjo reformë nuk arrit të ndryshonte Kushtetutën, duke lënë komunën si njësi të qeverisjes lokale.

Institucionet vendore janë:

- i. Qarku, i cili përfaqëson një unitet administrativo-territorial, të përbërë nga disa bashki me lidhje gjeografike, tradicionale, ekonomike, sociale dhe interesa të përbashkët¹⁹.
- ii. Bashkia, e cila përfaqëson një unitet administrativo-territorial dhe bashkësi banorësh²⁰.

Si Qarku dhe Bashkia luajnë rol thelbësor për zhvillimin e demokracisë lokale dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje. Ata janë institucione të cilat kanë një lidhje të ngushtë me komunitetin dhe janë të hapura ndaj nismave dhe propozimeve qytetare.

Institucionet vendore kanë detyrim të ndërmarrin disa përgjegjësi për nxitjen e iniciativave qytetare, konkretisht në:

Favorizimin dhe përkrahjen e iniciativave qytetare

Ato duhet të krijojnë mjedisin e duhur për zhvillimin dhe prezantimin e nismave qytetare. Kjo mund të përfshijë nxitjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe ofrimin e përkrahjes për propozimet qytetare.

Krijimin e mekanizmave për pjesëmarrje

Atyre u takon të krijojnë mekanizma dhe platforma të përshtatshme për pjesëmarrjen e qytetarëve. Këto mund të jenë sesione konsultimi publik, forume komunitare, apo mjedise virtuale për të mbledhur dhe shqyrtuar propozimet qytetare.

¹⁷ Neni 108, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

¹⁸ Neni 5, i ligjit 135/2015 “Për vetqeverisjen vendore”

¹⁹ Po aty ²⁰ Po aty

Transparencë dhe informim

Sigurimi i transparencës dhe informacionit është thelbësor për pjesëmarrjen e qytetarëve. Institucioneve vendore duhet të sigurojnë që informacioni rreth proceseve vendimmarrëse, planifikimeve dhe propozimeve të jetë i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë.

Vlerësimin dhe zbatimin i nismave qytetare

Institucionet vendore vlerësojnë dhe marrin në konsideratë propozimet dhe nismat qytetare gjatë proceseve vendimmarrëse të këshillave. Ata duhet të kenë një mekanizëm të qartë për shqyrtimin dhe zbatimin e këtyre propozimeve në praktikë.

Krijimin e partneriteteve lokale

Në disa raste, institucionet vendore krijojnë partneritete dhe bashkëpunime me organizatat jo-qeveritare, shoqatat civile, dhe komunitetet lokale për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe realizimin e nismave qytetare.

Edukimin dhe informimin e qytetarëve

Institucionet vendore duhet të investojnë në fushatën e edukimit dhe informimit të qytetarëve rreth mundësive për pjesëmarrje, procedurave vendimmarrëse, dhe rëndësisë së nismave qytetare.

3.1 Roli i bashkisë në iniciativat qytetare

Bashkitë luajnë rol thelbësor në zhvillimin e nismave qytetare. Neni 20 i Ligjit “Për vetqeverisjen vendore” i njeh qytetarëve të drejtën për të iniciuar nisma në bashkinë ku banojnë²¹. Kjo dispozitë u mundëson qytetarëve të dërgojnë iniciativën e tyre drejt parlamentit lokal, këshillit bashkiak.

3.2 Roli i qarkut tek iniciativat qytetare

Pavarësisht se qarku nuk ka një rol të shprehur mbi nismat qytetare, ai luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Disa aspekte të rëndësishme janë:

²¹ Neni 20 “Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.”

Administrimi dhe zhvillimi lokal

Qarku luan një rol të rëndësishëm në menaxhimin e shërbimeve publike siç janë planifikimi urban dhe infrastruktura. Kjo ndihmon në përmirësimin e cilësisë së jetës së njerëzve dhe në zhvillimin e qëndrueshëm të zonës. Ai përmes konsultimeve me qytetarëve mundëson një infrastrukturë të përmirësuar për qytetarët.

Financa dhe mbështetje për bashkitë

Qarku ofron mbështetje financiare dhe këshillimore për bashkitë. Kjo përfshin ndarjen e fondeve për projekte të ndryshme lokale dhe ndihmën në zbatimin e tyre.

Nxitja e pjesëmarrjes së qytetarëve

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është organizimi i takimeve publike dhe diskutimeve për çështje lokale. Këto aktivitete ofrojnë një platformë për qytetarët që të shprehin mendimet e tyre dhe të ndikojnë në vendimet që merren.

Hapësirat dhe burimet lokale

Qarku menaxhon burimet dhe hapësirat publike si parqet dhe sheshet. Këto hapësira mund të shfrytëzohen për aktivitete rekreative dhe ngjarje komunitare, duke ndihmuar në forcimin e ndjenjës së bashkësisë.

Ndihma për nismat qytetare

Qarku mund të ofrojë ndihmë financiare dhe teknike për nisma qytetare të cilat sjellin vlerë për komunitetin. Kjo mund të përfshijë aplikimin për grante dhe organizimin e trajnimeve.

Hapësira për konsultime dhe pjesëmarrje

Qarku mundëson hapësira për konsultime në mënyrë që qytetarët të jenë pjesëmarrës në hartimin e politikave lokale. Kjo mund të realizohet përmes forumeve, takimeve tematike dhe rrjeteve sociale, duke e bërë procesin vendimmarrës më transparent dhe gjithëpërfshirës.

4

Procedura për nismat qytetare pranë bashkive të vendit

Ligji për vetëqeverisjen vendore parashikon se procedura për nismat qytetare duhet të rregullohen në rregulloren e Këshillit Bashkiak²². Deri më tani 40 bashki kanë miratuar rregullore të posaçme për nismat qytetare, 10 e kanë të përfshirë në rregulloren e organizimit të Këshillit Bashkiak, ndërsa 11 nuk e kanë të parashikuar fare.

INIVICATIVA QYTETARE	BASHKIA
Të parashikuara me rregullore të posaçme	Berat, Bulqizë, Dibër, Divjakë, Durrës, Elbasan, Fier, Finiq, Gjirokastrë, Këlcyrë, Klos, Kolonjë, Konispol, Korçë, Kuçovë, Kukës, Lezhë, Lushnje, Malësi e Madhe, Maliq, Mallakastër, Memaliaj, Mirditë, Patos, Peqin, Përmet, Pogradec, Prrenjas, Pukë, Pustec, Roskovec, Selenicë, Shijak, Skrapar, Shkodër, Tepelenë, Tropojë, Vau i Dejës, Vlorë dhe Vorë
Të parashikuara në rregulloren e Këshillit Bashkiak	Tiranë, Delvinë, Devoll, Dimal, Dropull, Has, Kamëz, Krujë, Poliçan dhe Sarandë
Të cilat nuk janë parashikuara në asnjë mënyrë.	Belsh, Cërrik, Fushë Arrëz, Gramsh, Himarë, Kavajë, Kurbin, Libohovë, Librazhd, Mat dhe Rogozhinë.

²²Neni 20 "Çdo komunitet, nëpërmjet përfaqësuesve të autorizuar të tij, ose jo më pak se një për qind e banorëve të bashkisë ka të drejtë të paraqesin për vendimmarrje në këshillin bashkiak iniciativa qytetare për çështje që janë brenda juridiksionit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Mënyra dhe forma e paraqitjes së këtyre iniciativave, procedura e shqyrtimit dhe miratimit të tyre përcaktohet në rregulloren e organizimit dhe funksionimit të këshillit bashkiak"

4.1 Hapat e parë për iniciativën qytetare

Parashikimet ligjore për procedurën që ndiqet për zhvillimin e iniciativave qytetare janë të ngjashme ose identike nga një bashki në tjetrën. Siç është spjeguar më lart disa bashki kanë miratuar rregullore të posaçme, ndërsa disa të tjera e kanë të trupëzuar në rregulloren e përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e këshillit bashkiak. Përshkrimi i hapave për realizimin e iniciativave qytetare do të bazohet në rregulloren e posaçme me titull *“Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare”* të qytetit të Dibrës²³.

Për të ndërmarrë një iniciativë qytetare duhet të përmbushen dy kushte:

- i. Të nënshkruhet nga 1 përqind ose në raste të veçanta 2% të zgjedhësve të komunitetit ose jo më pak se 20 nënshkrues. Zgjedhës është çdo qytetar i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe ka shtetësi shqiptare. Personat të cilët përjashtohen nga kjo e drejtë janë ata, të cilëve ju është hequr zotësia për të vepruar ose që me ligj iu është hequr kjo e drejtë. Nga kjo e drejtë përfitojnë dhe personat të cilët janë dënuar dhe janë duke vuajtur dënimin në një nga burgjet e vendit.
- ii. Të plotësojë kriteret formale dhe materiale në hartimin e një projektvendimi. Rregulloret e bashkisë parashikojnë disa kriteret të cilat duhet të plotësojë iniciativa. Ajo duhet të hartohet në formën e një akti normativ dhe duhet të përmbajë një relacion ku të shpjegojë objektivin e tij, ndikimin që do të ketë në shoqëri.

Iniciativa duhet të ketë një objekt të qartë, e cila konsiston një kërkesë për t’u shqyrtuar e miratuar në këshill një akt normativ nënligjor apo një akt që shfuqizon apo ndryshon një akt normativ të këshillit, apo një rezolutë²⁴.

Iniciativa qytetare ndërmerren për çështje që lidhen me përgjegjësitë ligjore të këshillit bashkiak dhe që janë brenda juridiksionit të bashkisë perkatëse dhe kompetencës së këshillit të saj, po ashtu edhe për çështje që ndikojnë drejtpërsëdrejti bashkësisë dhe territorit të bashkisë, dhe për të cilat këshilli bashkiak ka autoritetin për të marrë një vendim.

Megjithatë jo çdo çështje mund të ngrihet nga qytetarët. Qytetarët nuk mund t’i drejtohen këshillit bashkiak për:

²³ <http://dibra.gov.al/wp-content/uploads/2020/11/Rregullore-Keshillit-Bashkiak-per-Ankesat-Kerkesat-Peticionet-dhe-Iniciativa-Qytetare.pdf>

²⁴ Neni 69 i Rregullores

- a. një projektakt që nuk është brenda funksioneve dhe kompetencës ligjore të bashkisë,
- b. një projektakt që kufizon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
- c. ndryshimin e buxheti dhe paketës fiskale, apo vendimit për shitjen apo dhënien me qera të një prone.
- d. ndryshimin e kufijve të bashkisë, qytetit dhe fshatrave.

Rregulloret parashikojnë se për iniciativën duhet të krijohet një grup parashtruesit të cilët do të ndjekin hap pas hapi procedurën që nga hartimi e deri tek votimi në këshillin bashkiak. Parashtruesit mund të jenë:

- a. minimumi pesë (5) zgjedhës të regjistruar të bashkisë
- b. përfaqësues të autorizuar të një shoqatë jo-fitimprurëse, shoqatë biznesi, sindikatë, me kusht që aktiviteti i organizatës të zhvillohet në mënyrë të përkohshme apo të përhershme brenda territorit të bashkisë dhe të kenë adresën në territorin e bashkisë jo më pak se një vit nga data e regjistrimit në bashki ku ndërmerret iniciativa
- c. kryetari i fshatit dhe ndërmjetësi komunitar, mbi bazë të vendimit të kryesisë së fshatit dhe këshillit komunitar²⁵.

Parashtrues mund të jenë dhe njëherësh disa prej kategorive sëbashku.

Parashtruesit dhe nënshkruesit e iniciativës nuk mund të jenë deputetë, anëtarët e këshillit bashkiak, zëvendëskryetar i bashkisë, sekretar i këshillit bashkiak, nëpunës civil të administratës së bashkisë, titullarë të institucioneve dhe drejtues të ndërmarrjeve në varësi të bashkisë, prefekti i qakut, kryetari i këshilli të qarkut, ministër, zëvendësministër, drejtues të agjensive qeveritare qendrore në nivel qarku, drejtues të institucioneve shtetërore kombëtare²⁶.

Rregulloret përjashtojnë me të drejtë zyrtarët e lartë, në mënyrë që të jenë qytetarët ata të cilët ndërmarrin dhe përfundojnë iniciativën pa patur asnjë mbështetje nga këta të fundit.

Nuk mund të jenë parashtrues të një iniciative individët që kanë marrëdhënie familjare apo të bashkëjetesës, si bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja, fëmijët, prindërit e parashtruesit të iniciativës e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es,

²⁵ Neni 72 i Rregullores

²⁶ Po aty

të afërmit e parashtruesit deri në shkallë të dytë, apo bashkëpronarë në biznes të parashtruesit, si dhe persona që janë kushërinjë të parë²⁷.

Parashtruesit duhet që të paraqesin me iniciativën edhe gjeneralitet e tyre të shoqëruar me kopje të dokumentit personal të identifikimit. Nëse parashtruesit nënshkruajnë si anëtarë të një oganizate ose grupi interesi, ata duhet t'i bashkëngjisin iniciativës edhe autorizimin e organizatës/grupit përkatës për nënshkrimin e iniciativës. Gjithashtu, ata duhet parashtruesit të lënë një person kontakti në mënyrë që të jetë më i lehtë komunikimi për vijueshmërinë e nismës.

Parashtruesit kanë për detyrë të hartojnë iniciativën sipas përcaktimeve të rregullores²⁸. Në këtë mënyrë iniciativa paraqitet me shkresë në letër të bardhë në formatin A4 dhe ka jo më shumë se njëzet (20) nënshkrime për çdo fletë. Iniciativa duhet te këtë dy faqe ku në faqen e parë e çdo flete përmban:

- i. Citimin që i drejtohet Këshilli Bashkiak (Emri i Bashkisë),
- ii. Bazën ligjore të iniciativës, e cila buron nga neni 20 i Ligjit 135/2015 si dhe nenet e rregullores përkatëse sipas bashkisë
- iii. Titullin e iniciativës
- iv. Kërkesën e iniciativës që paraprihet me shprehjen "Ne të nënshkruarit, me këtë iniciativë, i kërkojmë Këshillit Bashkiak (emri i bashkisë) të..."
- v. Arsyet e paraqitjes së iniciativës
- vi. Emrin dhe mbiemrin, numrin personal të identifikimit, adresën e banimit, adresën elektronike dhe numrat e telefonisë fikse apo celulare, si dhe nënshkrimin e parashtruesve të iniciativës

Ndërsa në faqen e dytë duhet të ketë:

- i. Deklaratën se "Unë nënshkruari deklaroj në përgjegjësinë time se informacioni i dhënë është i vërtetë dhe i saktë, dhe se nënshkrimi që kam bërë është autentik, dhe se unë kam mbështetur këtë iniciativë vetëm një herë".
- ii. Nënshkrimet e mbështetësve të peticionit, ku çdo rresht duhet të ketë emrin, kontaktet dhe nënshkrimin e nënshkruesve, duhet të kenë një numër.
- iii. Një paragraf ku të citohet se të dhënat personale do të përdoren vetëm për qëllimet e peticionit, dhe mbrohen nga ligji për mbrojtjen e të dhënave personale

²⁷ Po aty

²⁸ Neni 48 i Rregullores

- iv. Numrin e identifikimit të iniciativës
- v. Citimin se emrat e nënshkruesve janë të hapur për publikun.
- vi. Afatin e (data dhe ora) e përfundimit të nënshkrimeve të iniciativës

Çdo faqe e petitionit duhet të këtë numrin e faqes (p.sh. faqja 1 nga 8, faqja 2 nga 8 etj, dhe numërimi duhet të jetë i vazhduar nga numri 1 deri tek numri i fundit i listës së nënshkruesve). Më poshtë do të paraqitet një format iniciative në mënyrë ilustruese.

Model peticioni për iniciativë qytetare drejtuar këshillit bashkiak

Model Peticioni për Iniciativë Qytetare drejtuar Këshillit Bashkiak

(faqja e parë e çdo flete të peticionit)

PETICION PER INICIATIVE QYTETARE

Drejtuar: Këshillit Bashkiak _____

Adresa: _____ Tel: _____ Cel: _____ Email: _____

1. Ne, të nënshkruarit banorë të regjistruar të Bashkisë _____, të Qarkut _____, dhe banues në adresat e përcaktuara anash emrave tanë përkatës, me respekt kërkojmë:

2. Kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak/ Komisionit të Përhershëm është: që akti/vendimi i mëposhtëm të miratohet nga Këshilli i Bashkisë _____ ose, nëse nuk miratohet nga Këshilli i Bashkisë, kërkojmë t'i paraqitet për votim referendar banorëve të Bashkisë _____.

3. Titulli i projekt aktit/vendimit (projekt akti i plotë është bashkëngjitur këtij peticioni)

(Këtu vendoset titulli i projekt aktit/ vendimit të propozuar, duke siguruar që akti/ vendimi i propozuar nuk përmban më shumë se një lëndë dhe që lënda shprehet qartë në titull. Titulli i peticionit duhet të jetë në çdo fletë të peticionit)

(Teksti i plotë i projekt aktit/vendimit është si më poshtë) ose

(Një kopje e plotë dhe e saktë e projekt aktit/vendimit i bashkëngjitet këtij Peticioni)

4. Baza ligjore të peticionit është neni 19/1 i Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisje vendore"; Baza ligjore e çështjes që trajton kërkesa është neni ___ i Ligjit nr. _____ "Për _____",

5. Situata/Çështja që nxiti dorëzimin e këtij peticioni është: _____

6. a) Territori që mbulon përkesa e peticionit është (specifikoj me √ apo citoni emrin): Bashkia; ii. njësi administrative nr ___ / emri ___; iii. fshati ___; iv. lagjia ___; fshatrat ____, lagjet ____.

6. b) Grupi i interesit _____

7. Përfaqësia Promovese e Iniciativës përbëhet nga:

7.a) Emri _____ Mbiemri _____ ID _____ *(person kontakti)*

Firma _____ Tel: _____ Cel: _____ Email: _____

7.b) Emri _____ Mbiemri _____ ID _____

8. Afati i nënshkrimit të peticionit është data _____ ora _____.

9. Dokumentet shoqëruese të peticionet janë (nëse ka):

a)

b)

(faqja e dytë e çdo flete të peticionit)

10. Titulli i projekt aktit/vendimit që propozojmë është si më poshtë: _____

11. Unë i nënshkruari deklaroj në përgjegjësinë time se informacioni që kam dhënë është i vërtetë dhe i saktë, dhe se nënshkrimi që kam bërë është autentik, dhe se unë ka mbështetur këtë peticion vetëm një herë.

Nr.	Emri	Mbiemri	ID	Adresa	Banor (B)/ Org (emri)	Firma	Data
1							
2							
20/50							

12. Mbrojtja e të dhënave personale, citimi.

13. Numrin e identifikimit të peticionit.

14. Citimi se peticioni dhe nënshkrimet janë të hapura për publikun

15. Data dhe ora e përfundimit të nënshkrimeve të peticionit.

SHKRESA PERMBLEDHESE E PETICIONIT	
PARASHKRUESI KRYESOR I PETICIONIT	
Emri, Atësia, Mbiemri	
Numri personal i identifikimit	
Adresa e banimit	
Email:	
Nr. i cel:	
TE DHENAT E PETICIONIT	
Titulli i Peticionit:	
Numri i parashtruesve	
Numri i nënshkruesve të peticionit (m bështetësit)	
Dorëzimi i peticionit pranë bashkisë (data)	
Mënyra e dorëzimit të peticionit	<input type="checkbox"/> Pranë zyrës së protokollit të bashkisë <input type="checkbox"/> Pranë Zyrës me Një Ndalesë të bashkisë
Nr. i fletëve me nënshkrime	
Nr. anëtarëve të grupeve të mbledhjes së nënshkrimeve	
Nr. i grupeve të mbledhjes së nënshkrimeve	
Nr. i procesverbaleve të grupeve të mbledhjes së nënshkrimeve	
1. Dokument shoqërues i peticionit	Emërtesa _____ Nr. i fletëve _____
2. Dokument shoqërues i peticionit	Emërtesa _____ Nr. i fletëve _____
3. Dokument shoqërues i peticionit	Emërtesa _____ Nr. i fletëve _____

Firma e parashtruesit kryesor të peticionit

Shpenzimet për përgatitjen e fletëve të mbledhjes së nënshkrimeve, për mbledhjen e nënshkrimeve, si dhe përdorimin e mjediseve private nëse ka të tilla, përballohen nga Përfaqësia e Iniciativës²⁹. Ata mund të përdorin fonde nga donatorë, banorë, organizata apo biznese për financimin e iniciativës, por duhet t'i bëjnë publike donatorët pranë Bashkisë dhe në faqen e internetit apo median sociale të tyre.

Megjithatë, rregullorja parashikon se Këshilli Bashkiak mund të miratojë një ndihmë financiare prej një (1) Euro për secilin prej nënshkrimeve të mbledhura, por jo më shumë se totali i numrit të nënshkrimeve minimale (p.sh 1% e banorëve të Bashkisë, apo 2% e banorëve të njësisë administrative, lagjes, fshati)³⁰.

Pasi kanë hartuar iniciativën sipas kërkesave të mësipërme, parashtruesit duhet ta dërgojnë pranë protokollit të Bashkisë përkatëse³¹. Aty do të verifikohet nga administrata e bashkisë nëse përmbushen kriteret apo jo të iniciativës³².

Në rast të mospërmbushjes së njërit prej kriterëve të mësipërme, iniciativa do të kthehet parashtruesve për korrigjime³³.

Iniciativa publikohet në faqen zyrtare të bashkisë me të gjithë dokumentat përkatës.

4.2 Mbledhja e nënshkrimeve

Parashtruesit e iniciativës, pasi kanë përfunduar hartimin dhe rregjistrimin pranë bashkisë, zgjedhin “Grupin për mbledhjen e nënshkrimeve” (GMN). Anëtarët e këtij grupi duhet të listohen me të gjitha të gjeneralitetet, në një procesverbal të nëshkruar nga të gjithë parashtruesit. Ky vendim i dërgohet bashkisë përmes personit të kontaktit të parashtruesve. Nënshkrimi mund të bëhet në disa mënyra:

Fizikisht

Qytetarët paraqiten në vendet e mbledhjes së nënshkrimeve. Ata nënshkruajnë vetëm një herë dhe është detyra e GMN-së të garantojë nënshkrimin vetëm një herë. Nënshkrimi duhet të bëhet me stilolaps me ngjyrë blu. Asnjë person nuk lejohet:

- i. të nënshkruajë në emrin e një personi tjetër në çfarëdo rrethane,
- ii. të nënshkruajë në më shumë se në një fletë të nënshkrimeve, për të njëjtin iniciativë,
- iii. të nënshkruajë një iniciativë kur nuk ka të drejtë ta nënshkruajë atë

²⁹ Neni 91 | Rregullores

³⁰ Neni 92 | Rregullores

³¹ Neni 75 | Rregullores

³² Neni 76 | Rregullores

³³ Po aty

Nënshkrimi në vendin e zgjedhësit

Qytetarët nuk kanë mundësi të shkojnë në vendin e përcaktuar nga Parashtruesit. Për të përmbushur vullnetin e tyre, ligji ka parashikuar që GMN-të të shkojnë në vendin ku ata ndodhen. Kjo praktikë përdoret në raste të veçanta kur:

- i. Qytetarët kanë probleme shëndetësore dhe e kanë të pa mundur nënshkrimin në vendin e caktuar

Nënshkrimi elektronik

Aktualisht ekzistojnë disa ligje në lidhje me vlefshmërinë dhe përdorimin e dokumentit dhe nënshkrimit elektronik³⁴. Parashtruesit dorëzojnë me shkrim në bashki, kërkesën për krijimin e iniciativës elektronike, së bashku me të dhënat e saj dhe të dhënat e parashtruesve që do të përdorin platformën elektronike. Përdorimi i platformës elektronike të bashkisë bëhet nëpërmjet vendosjes përmes sistemit elektronik i cili vendoset në dispozicion nga bashkia. Ngarkimi i dokumenteve në platformën elektronike është përgjegjësi e parashtruesve të iniciativës³⁵.

4.3 Afati i mbledhjes së nënshkrimeve

Afati për mbledhjen e nënshkrimeve miratohet nga këshilli bashkiak me propozim të Përfaqësisë së Iniciativës. Në çdo rast është jo më pak se dy (2) muaj dhe jo më shumë se gjashtë (6) muaj. Kërkesa e Përfaqësisë për përcaktimin e afatit të fillimit dhe përfundimit të nënshkrimeve të iniciativës, shqyrtohet në mbledhjen më të parë të Këshillit mbas regjistrimit të kësaj kërkesë në bashki. Nëse këshilli nuk shprehet me vendim, afati i iniciativës mbetet ai i propozuar nga Përfaqësia e Iniciativës.

Nëse Përfaqësia e Iniciativës nuk arrin ta shpërndajnë për nënshkrim iniciativën, brenda një (1) viti nga publikimi i iniciativën në faqen e internetit të bashkisë, përfaqësia duhet të ri-paraqesë iniciativën nga fillimi për pranim pranë bashkisë³⁶. Në rastin e nënshkrimeve elektronike afati i mbylljes së nënshkrimeve elektronike është jo më shumë se dy (2) apo tre (3) muaj³⁷.

³⁴ Ligji nr. 9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar; Ligji nr.10273/2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar; Ligji nr. 10325/2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”; Ligji nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar.

³⁵ Neni 61 I Rregullores

³⁶ Neni 78

³⁷ Neni 61

4.4 Vendi i mbledhjes së nënshkrimeve

Përfaqësia i propozon kryetarit të bashkisë mjediset për mbledhjen e nënshkrimeve të iniciativës. Këto mjedise duhet të mbajnë jo më shumë se 500 apo 1000 nënshkrues për një mjedis nënshkrimi.

Kryetari i bashkisë merr vendim për caktimin e mjediseve, jo më vonë se njëzet (20) ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës nga Përfaqësia. Në rast se Kryetari i Bashkisë nuk merr vendim brenda afatit njëzet (20) ditor, mjediset për mbledhjen e nënshkrimeve përcaktohen nga vetë Përfaqësia. Vendndodhja e mjediseve bëhet publike nga Përfaqësia përmes njoftimit në faqen e internetit të iniciativës, si dhe në mjediset e jashtme të bashkisë.

4.5 Dorëzimi i nënshkrimeve & iniciativës pranë këshillit bashkiak

Përfaqësia dorëzon dhe regjistron njëherazi pranë bashkisë të gjithë dokumentacionin e iniciativës qytetare, që kërkohet nga nga ligji dhe rregullorja³⁸ jo më vonë se pesë (5) ditë pas përfundimit të procesit të mbledhjes së nënshkrimeve. Dokumentacioni i iniciativës përfshin:

- i. Fletët e mbledhjes së nënshkrimeve,
- ii. dokumentet shoqëruese të iniciativës,
- iii. projektaktin e propozuar,
- iv. relacionin shpjegues të projektaktit,
- v. procesverbalet e mbajtura nga grupet mbështetëse,
- vi. kërkesat e nënshkruesve që nuk mund të nënshkruajnë në vendet publike dokumentet e tjera që lidhen me procesin e nënshkrimeve,
- vii. fletët e nënshkrimeve të papërdorura apo të dëmtuara.

Të gjitha fletët e nënshkrimeve të iniciativës duhet të jenë të vulosura me vulën e bashkisë. Po ashtu çdo dokumentet tjetër i iniciativës duke përfshirë projektaktin, relacionin shpjegues të projektaktit dhe procesverbalet e grupeve të mbledhjes së nënshkrimeve duhet të jenë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e Përfaqësisë. Parashtruesit mund të autorizojnë, me shkrim, një përfaqësues për të paraqitur iniciativën në emër të tyre.

³⁸ Shih nenet 83 dhe 84 të rregullores

Procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit të procesit të nënshkrimit, i cituar më sipër, firmoset nga personi i autorizuar i Përfaqësisë dhe drejtuesi i zyrës së protokollit të bashkisë. Komisioni për iniciativat qytetare pranë këshillit bashkiak verifikon vlefshmërinë e iniciativës dhe kontrollon nënshkrimet brenda një afati tridhjetë (30) ditor pas datës së dorëzimit të dokumenteve të iniciativës pranë bashkisë.

Komisioni ngren grupin për verifikimin e vlefshmërisë së iniciativës dhe kontrollin e nënshkrimeve. Grupi drejtohet nga kryetari i komisionit dhe ka një anëtar nga grupi i këshilltarëve të shumicës dhe grupit më i madh i këshilltarëve të pakicës në këtë komision, sekretarin e këshillit, si dhe drejtuesin e drejtorisë/sectorit juridik të bashkisë. Grupi ndihmohet nga punonjësit e sekretariatit të Këshillit apo punonjës të tjerë të administratës së bashkisë të caktuar nga Kryetari i Bashkisë. Vendimi dhe raporti i verifikimit i paraqiten Komisionit për Peticionet. Grupi i verifikimit vlerëson nëse janë plotësuar kërkesat ligjore për iniciativën të trajtuara gjatë këtij kapitulli. Më pas komisioni bën verifikimin e nënshkrimeve dhe të dhënave të nënshkruesve të iniciativës.

Të dhënat e nënshkruesve dhe nënshkrimet e tyre verifikohen kundrejt listës së votuesve me nënshkrime të bëra gjatë zgjedhjeve të fundit, qofshin ato të përgjithshme apo vendore. Nëse verifikohen parregulsi të nënshkrimeve të iniciativës apo numri i nënshkrimeve të pavlefshme është i barabartë me numrin e nënshkrimeve që e bën të pavlefshme iniciativën, grupi njofton Përfaqësinë për numrin e nënshkrimeve që duhen plotësuar, në të kundërt iniciativa refuzohet. Komisioni cakton një afat kohor për plotësimin ose korrigjimin e pasaktësive të nënshkrimeve, apo dërgimin e nënshkrimeve shtesë.

Në rastin kur nënshkrimet janë bërë në shkresë dhe në platformë elektronike, fillimisht verifikohen nënshkrimet në shkresë dhe krahasohen në mënyrë të kryqëzuar me ato elektronike, për të fshirë çdo dublikate, pasi vetëm një nënshkrim do të numërohet.

Grupi shqyrton çdo ankesë të bërë nga banorët e bashkisë apo organizata, për pavlefshmërinë e nënshkrimeve të dorëzuara në bashki. Grupi shqyrton ankesën, bën verifikimet përkatëse dhe i kthen përgjigje ankuesit përmes shkresës së firmosur nga kryetari i grupit brenda pesë (5) ditëve nga depozitimi në bashki i ankesës.

Grupi vlerëson iniciativën të pavlefshme nëse:

- i. Fletët nuk janë sipas formatit të miratuar nga Bashkia.
- ii. Iniciativa është tërhequr.

- iii. Numri i nënshkrimeve të dorëzuara nga Përfaqësia brenda afati të dorëzimit të nënshkrimeve, është më i vogël së numri i kërkuar për vlefshmërinë e iniciativës.
- iv. Emrat dhe adresat e banimit të shumicës së parashtruesve të iniciativës kanë ndryshuar, apo asnjë nga parashtruesit nuk komunikon ndaj kërkesave të bashkisë përgjatë procesit të vlerësimit apo verifikimit të iniciativës.
- v. Me përfundimin e verifikimit, Grupi merr vendim t'i dërgojë Komisionit për Peticionet, njërin nga propozime në vijim:
- vi. Pranimin për shqyrtimin nga Këshilli për Iniciativa Qytetare;
- vii. Refuzimin e pranimin të iniciativës për shqyrtim nga Këshilli.

Vendimi i grupit për vlefshmërinë e iniciativës dokumentohet në procesverbalin e mbledhjes së grupit, procesverbal i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e grupit. Komisioni për Peticionet shqyrtton propozimet e grupit të verifikimit dhe nëse do ta miratojë apo ta refuzojë iniciativën.

Nëse komisioni vendos për refuzimin e iniviatives, komisioni e informon këshillin për vendimin në mbledhjen e parë të radhës. Përfaqësia njoftohet jo më vonë së pesë (5) ditë nga data e marrjes së vendimit. Nëse iniciativa pranohet për shqyrtim nga Këshilli, kryetari i Komisionit të Peticioneve i dërgon Kryetarit të Këshillit vendimin e komisionit shoqëruar me dosjen e të gjithë dokumentacionit të iniciativës.

Mbas shqyrtimit të kërkesës së iniciativës nga komisioni përkatës, kryetari i komisionit i dërgon Këshillit Bashkiak raportin e shqyrtimit të projektaktit nga komisioni, projektaktin dhe relacionin shpjegues të projektaktit të dërguar nga Përfaqësia bashkëlidhur iniciativës qytetare, vlerësimin paraprak të shpenzimeve financiare për zbatimin e projektaktit, mendimet e publikut të dhëna në dëgjuesën publike, si dhe vendimi i Komisionit për Peticionet në lidhje me vlefshmërinë e iniciativës.

Kryetari i Këshillit mund të thërrasë një seancë këshillimi me publikun në lidhje me iniciativën. Në seancë ftohen të marrin pjesë edhe kryetari i komisionit për peticionet, kryetarët e grupeve më të mëdha politike të këshilltarëve bashkiakë dhe përfaqësues të drejtorisë/vektorit që mbulon çështjet që trajton iniciativa qytetare. Data, vendi dhe ora e mbajtjes së seancës njoftohet publikisht në faqen e internetit të bashkisë dhe në median sociale zyrtare të Këshillit Bashkiak jo më vonë se shtatë (7) ditë nga data e mbajtjes së seancës.

Në këtë seancë banorëve apo palëve të interesuara që janë kundër iniciativës u jepet mundësia të japin opinionet dhe komentet e tyre për një afat kohor jo më shumë se njëzet (20) minuta. Komentet e tyre regjistrohen në procesverbalin e seancës dhe bëhen publike. Mendimet e shprehura nga publiku në këtë seancë

këshillimi bëhen pjesë e raportit të komisionit të përhershëm përkatës dhe paraqiten në mbledhjen e këshillit ku do të shqyrtohet iniciativa.

Në rast se propozimet e ardhura në Këshill kanë ndikim financiar në buxhetin e bashkisë, nuk shqyrtohen dhe as miratohen në këshill sipas rendit të ditës pa marrë më parë mendimin e kryetarit të bashkisë³⁹. Kryetari i Këshillit i dërgon Kryetarit të Bashkisë kopje të një flete të iniciativës qytetare me kërkesën për t'u shprehur në lidhje me ndikimin financiar të iniciativës qytetare në buxhetin e Bashkisë, nëse ka.

Kryetari i Bashkisë i kthen përgjigje Këshilli brenda dhjetë (10) ditëve nga marrja e kërkesës, dhe nëse brenda këtij afati Kryetari i Bashkisë nuk kthen përgjigje, Këshilli Bashkiak ka të drejtë të vazhdojë me shqyrtimin e iniciativës⁴⁰.

4.6 Shqyrtimi i iniciativës në mbledhjen e këshillit

Iniciativa qytetare shqyrtohet në mbledhjen më të afërt të Këshillit Bashkiak, që nga momenti i pranimin të iniciativës. Shqyrtimi nga Këshilli i iniciativës bëhet sipas rregullave të mbledhjes së Këshillit dhe vendimi për iniciativën merret jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e depozitimit të iniciativës për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

Këshilli Bashkiak vendos për pranimin, ndryshimin apo hedhjen poshtë të kërkesës së iniciativës qytetare, vendimi i cili merret me shumicën e votave të të gjithë këshilltarëve bashkiak. Në rast refuzimi apo rrëzimi të iniciativës, Përfaqësia mund të ankohet në gjykatën administrative.

³⁹ Ligji nr. 139/2015, Neni 20/2

⁴⁰ Neni 87

Rregulla për hartimin e nisme vendore

Më poshtë do të trajtohen disa rregulla të përgjithshme të hartimit të nismave vendore. Hartimi gjuhësor i një iniciative vendore është një proces i rëndësishëm për sigurimin që teksti të jetë i qartë, i kuptueshëm dhe i përshtatshëm jo vetëm për administratën bashkiake, por për të gjithë qytetarët. Për të hartuar një nismë është e këshillueshme kontributi jo vetëm i juristëve por edhe profesionistëve të fushës e cila do të rregullohet nëpërmjet nismës⁴¹.

Megjithatë ky kapitull synon të japë një panoramë të përgjithshme të rregullave bazë për hartimin e një nisme. Duke qënë se dhe nisma është një akt normativ, rregullat janë të ngjashme me atë të hartimit të një ligji. Më poshtë do të trajtohen parime të përgjithshme të cilat duhen marrë parasysh për të formuluar një akt normativ.

5.1 Parimet e hartimit të një nisme

Propozimet⁴² për nismën duhet të jenë të qarta dhe të kuptueshme. Ato duhen të synojnë të rregullojnë në periudhë afatgjatë një problematikë. Kështu nismëtarët duhet të bëjnë një kërkim të detajuar mbi fushën konkrete, të analizojnë nevojën e ndryshimeve dhe më pas ta shkruajnë. Propozimet duhet të jenë të mirëmenduar, të mos bien ndesh me Kushtetutën dhe ligjet në fuqi.

5.1.1 Parimi i ligjshmërisë

Ky parim duhet respektuar që në nisjen e hartimit të një propozimi. Baza ligjore duhet të citohet në preambulën e nismës, për të garantuar se është në përputhje me legjislacionin e vendit dhe të bashkisë.

Shembull: Në mbështetje të neni 20/1 i Ligjit nr. 139/2015“Për vetëqeverisje vendore”

5.1.2 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

Propozimet duhet të trajtojnë në të njëjtën mënyrë rastet të ngjashme. Asnjë nismë nuk duhet të krijojë situata diskriminuese në realitet. Kjo nuk pengon ekzistencën e neneve të caktuara, të cilat trajtojnë ndryshe situata me rrethana të caktuara.

⁴¹ Parime dhe rregulla për hartimin e akteve normative, S.Berberi, fq 7

⁴² Më poshtë iniciativa do t'i referohemi me fjalën propozime

5.1.3 Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit

Përmes këtij parimi, nismëtarët duhet të analizojnë nëse një problematikë e caktuar ka ose jo nevojë për rregullim ligjor. Kjo do të thotë se ata duhet të vlerësojnë nëse qëllimi i tyre nuk mund të arrihet me mënyrë tjetër përveçse ligjit.

5.1.4 Parimi i efektivitetit

Një iniciativë është efektive vetëm nëse zbatohet dhe përmbush objektivat e synuara. Për tu zbatuar me përpikmëri duhet që propozimi të jetë i qartë dhe i drejtpërdrejtë. Ai nuk duhet të lërë hapësira për dyshime apo keqkuptime.

Anëtarët e bordit kanë mandat 4-vjeçar dhe e ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me parashikimet e legjislacionit për organet kolegjiale⁴³.

Dispozita e mësipërme ka një gjuhë të drejtpërdrejtë dhe direkt të zbatueshme. Çdo kush që e lexon mund të kuptojë detyrën e zgjedhësit.

5.1.5 Parimi i qartësisë

Iniciativat duhet të jenë të lexueshme dhe të kuptueshme lehtë. Hartuesit duhet të përzgjedhin mirë fjalët dhe të shmangin sa më shumë fjalë teknike, të kenë një terminologji uniforme dhe strukturë të saktë gramatikore.

5.1.6 Parimi i ekonomisë së tekstit

Një nismë duhet të shkruhet me sa më pak pika të jetë e mundur. Secili prej tyre nuk duhet të ketë fjali të gjata dhe të komplikuar. Përbërja e tyre duhet të shprehet me sa më pak fjalë për aq sa nuk humbasin kuptimin. Përkundrazi një nismë e gjatë e lodh lexuesin dhe nuk arrin të përcjellë qëllimin.

5.2 Gjuha e përdorur

Gjuha e përdorur në një tekst ligjor duhet të jetë e thjeshtë, marrë parasysh që atë do ta lexojnë janë qytetarët pavarësisht arsimit. Fjalitë duhet të jenë të shkurtra dhe të qarta. Ideja kryesore duhet të jepet në fillim të fjalisë nëse është e mundur. Çdo fjali duhet të përmbajë një numër të kufizuar konceptesh për të mos e rënduar shumë lexuesin. Fjalitë duhet të këtë këtë rend **kryefjalë - kallëzues - kundrinor - rrethor**.

⁴³ Shih vendimin Nr. 109, datë 15.11.2023, Këshilit Bashkiak Tiranë

- ✓ *“Anëtarët e bordit kanë mandat 4-vjeçar dhe e ushtrojnë veprimtarinë në përputhje me parashikimet e legjislacionit për organet kolegjiale”*

dhe jo

- ✗ *“Mandatin 4 vjeçar, anëtarët e bordit e ushtrojnë me parashikimet e legjislacionit”*

Fjalitë duhet të jenë në mënyrën dëftore dhe më mënyrë të drejtëpërdrejtë. Pjesëzat mohuese duhet të shmangen kur nuk është e nevojshme.

Fjalitë në një tekst formulohen në stil rrëfyës ose refererues

Stil rrëfyës:

- 1. Personi duhet të bëjë kërkesë në Drejtorinë Arsimore*
- 2. Kërkesa duhet të bëhet më shkrim.*

Stil referues:

- 1. Personi duhet të bëjë kërkesë në Drejtorinë Arsimore*
- 2. Kërkesa sipas pikës 1 duhet të bëhet më shkrim.*

Në fjalitë e teksit ligjor duhet të shmangët numëri shumë i fjalëve si dhe duhet të përdoret gjinia asnjëanëse. Fjalitë duhet të jenë në trajtën veprorë dhe koha e foljeve duhet të jetë në të tashmen.

Fjalët e përdorura duhet të jenë bashkëkohore dhe duhen përdorur në kuptimin e tyre të zakonshëm e kryesor. Duhet të shmangët përdorimi i fjalëve apo shprehjeve informale si dhe fjalëve arkaike të cilat nuk përdoren shpesh apo nuk kuptohen. Gjithashtu duhet të shmangen neologjizmat të cilat ende nuk janë bërë pjesë e përdorimit të përditshëm të gjuhës shqipe. Në rast se duhet të përdoret një nga fjalët e mësipërme, atëherë ajo duhet të përkufizohet që në fillim.

Të gjitha fjalët apo shprehjet duhet të jenë në gjuhën shqipe. Fjalët dhe shprehjet e huaja duhet të përdoren vetëm nëse ato janë pranuar në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe dhe për to nuk ka fjalë tjetër.

Shprehjet teknike duhet të shmangen, me përjashtim të rasteve kur ato bëjnë pjesë në gjuhën e zakonshme profesionale të personave të cilëve u drejtohet nisma.

Termat ligjorë duhet të jenë në kuptimin e tyre më të zakonshëm. Në rast se një prej tyre ka shumë kuptime duhet të përkufizohet në fillim.

Shkurtimet duhet të përdoren vetëm kur kjo lejohet nga praktika shqiptare dhe shkurtimi është gjerësisht i njohur e i pranuar.

Numrat duhet të shkruhen me shkronja kur përdoren në tekstin e legjislacionit. Emri i muajit shkruhet me shkronja dhe elementët e tjerë të datës shkruhen me numra arabë. Viti gjithmonë duhet shkruar në formën e plotë katër shifrorë.

5.3 Hapat e parë për formulimin e hartimin e një nisme

Nismëtarët duhet të hulumtojnë të gjithë kuadrin ligjor ekzistues për të vendosur nëse është i domosdoshëm ndërmarrja e nisme apo ndryshimi në vendimet ekzistuese të Këshillit Bashkiak. Gjatë këtij procesi kërkimor ata mund të hasin mungesën e gjetjes së vendimeve të këshillit bashkiak dhe kryetarit të bashkisë. Fillimisht, ata duhet të fillojnë kërkimin në faqen zyrtare të bashkisë. Nëse aktet nuk gjenden nismëtarët duhet t'i drejtohen postë elektronike ose me shkresë zyrtare, komisionerit për informim pranë bashkisë, duke i kërkuar vendosjen në dispozicion të akteve ndaj të cilave duan të njihen.

5.3.1 Vlerësimi dhe kostoja e iniciativës

Iniciativa duhet të jetë i efektshëm në të kundërt mungesa e zbatimit të tij mund të sjellë mosbesim dhe pasiguri të qytetarëve. Nismëtarët duhet të kenë parasysh se përmes iniciativave, synimi kryesor është zgjidhja e problemeve bashkëkohore dhe të një shumice të qytetarëve

Ndonëse është e vështirë në shumë raste, nismëtarët duhet të përcaktojnë dhe kostot financiare të iniciativave. Ata duhet të kryejnë një analizë për efektet që do të sjellë zbatimi i tij.

Shembull: Nëse do të parashikohen ndryshime për vendimet në lidhje me taksat vendore, duhet të parashikohet dhe kostoja financiare që do të rëndojë mbi bizneset lokale dhe qytetarët.

Shembull: Nëse ndryshimet parashikojnë krijimin e strukturave të reja duhet të përllogaritet dhe kostoja në buxhetin e bashkisë.

Parashikimi i kostove të iniciativës nuk janë të domosdoshme, pasi si rregull atë e projekton vetë bashkia. Me qëllim që nisma të jetë akoma më efektive iniciativës duhet t'i bashkëlidhet edhe analiza financiare.

5.3.2 Titulli dhe preambula

Teksti i iniciativës duhet të përbehet nga dy elementë formal të domosdoshëm, titulli dhe preambula. Titulli paraqet objektin që iniciativa do të rregullojë. Ai shkruhet me shkronja të mëdha (kapitale) dhe duhet të paraqitet në këtë format:

Projekt Vendim “PËR KRIJIMIN E BORDIT TË AGJENCISË SË INDUSTRIËS KREATIVE DIBËR”

Poshtë titullit vendoset preambula, e cila tregon bazën ligjore të iniciativat. Thënë ndryshe ajo tregon dispozitat ligjore që i japin të drejtën nismëtarëve të hartojnë një projektligj.

Në rastin e një nisme qytetare preambula duhet të formulohet: “Në mbështetje të nenit 20/1 i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

5.4 Dokumentet plotësuese krahas iniciativës qytetare

Rregullorja për nismat përcakton se nisma duhet të shoqërohet me një relacion i cili shpjegon nevojën për miratimin e nismës⁴⁴. Hartimi i relacionit sikurse do e shpjegojmë më poshtë është i rëndësishëm, pasi përmes tij anëtarët e këshillit bashkiak kuptojnë nevojën dhe qëllimin e nismës. Megjithatë më lart përmendëm⁴⁵ se fleta e nënshkrimeve duhet të përmbajë një shpjegim mbi iniciativës, nevojës së saj si dhe efektet në shoqëri. Kjo ia lehtëson punën nismëtarëve, pasi detyra në këtë rast është të detajojnë më shumë qëllimin e iniciativës dhe përputhshmërinë e saj me legjislacionin.

5.4.1 Relacioni

Relacioni shpjegon qëllimin dhe objektivat e nismës duke parashtruar ndryshimet ose risitë e tij në legjislacionin ekzistues. Relacionet shërbejnë për disa qëllime të ndryshme. Së pari ato informojnë anëtarët e këshillit bashkiak gjatë shqyrtimit të iniciativës, për të kuptuar më shumë rreth qëllimit dhe efekteve të saj. Relacionet informojnë publikun e gjerë dhe mediat në lidhje me nismën. Sa më i plotë dhe i saktë përmbajta e relacionit aq më i kuptueshëm është iniciativa e propozuar për qytetarët. Relacioni është i vlefshëm dhe pas miratimit të një initiative pasi ai orienton zbatimin e duhur të tij. Relacionet e paqarta, të dykuptimta mund të sjellin një interpretim dhe zbatim të iniciativat ndryshe nga ç’ ishte menduar.

Nga praktika e deritanishme nuk kemi modele të relacioneve të nismave të publikuara në faqen zyrtare të Bashkive. Për këtë arsye do të mbetet në të ardhmen për tu parë nëse do të kemi.

⁴⁴ Neni 68 i Rregullores së Kuvendit

⁴⁵ Shih faqen 6 të manualit

5.4.2 Efektet financiare

Efektet financiare të iniciativës duhet të përfshihen si për vitin fiskal në të cilin iniciativa hyn në fuqi, ashtu edhe për vitet pasardhëse, në rast se efekti do të jetë i mëvonshëm. Nismëtarët duhet të parashikojnë dhe shpenzimet për masave e mundshme përgatitore të nevojshme përpara hyrjes në fuqi të iniciativat. Ata duhet të përcaktojnë nëse efektet financiare i takojnë buxhetit të pushtetit qendror apo atij vendor.

5.5 Rregulla për hartimin e ndryshimeve

Nëse iniciativa ka për qëllim të propozojë miratimin e një rregulloreje apo akti tjetër normativ bashkiak, iniciativa duhet të shoqërohet me tekstin e plotë të propozimit, dhe sipas formatit që përdor bashkia në paraqitjen e projektakteve. Po ashtu, nëse iniciativa propozon një ndryshim të një rregulloreje apo akti tjetër normativ bashkiak, projektakti duhet të përfshijë nenet/paragrafët me tekstin e ndryshuar apo nenet/paragrafët alternativë.

Rregullat e kapitullit të mësipërm do të ndiqen edhe kur nismëtarët kërkojnë ndryshimin e një akti ose vendim i këshillit bashkiak ekzistues. Ndryshimet e aktit/vendimit mund të jenë të shprehura ose të heshtura. Ndryshime të shprehura tregojnë nenet ose pjesë të dispozitave që ndryshojnë ndërsa për ndryshimet e heshtura ndryshojnë dispozitat ekzistuese, pa e treguar shprehimisht.

Ndryshimet e heshtura duhet të shmangen pasi sjellin paqartësi.

Iniciativa mund të ndryshojë me shtimin e fjalëve të reja në tekstin e tij, me zëvendësimin, ose me shfuqizimin e disa dispozitave të vendimeve aktuale të këshillit bashkiak.

Është e rëndësishme që ndryshimet të mos krijojnë paqartësi gjuhësore dhe efekte juridike që nuk janë menduar.

Shtesa është vendosja e një fjalëve ose fjalive të reja brenda tekstit ekzistues të iniciativat. Shtesa mund të jetë një paragraf ose nënparagraf⁴⁶.

Zëvendësimi nënkupton zëvendësimin e disa pjesëve ekzistuese të tekstit, me tekst të ri⁴⁷.

⁴⁶ Manuali për Hartimin e Legjislacionit, faqja 117

⁴⁷ Po aty

Shfuqizimi është heqja e disa pjesëve ose e gjithë tekstit ekzistues të vendimeve ose akteve të bashkisë. Shfuqizimi mund të shoqërohet me ndryshime në të njëjtin vendim, apo dhe vendim të tjera.

Në rast ndryshimesh, titulli duhet të formulohet kështu:

*Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.____ të datës ____
“Për _____”*

Relacionet në funksion të ndryshimeve të vendimeve dhe akteve, duhet të shprehen në mënyrë krahasuese midis propozimit dhe vendimit aktual.

6

Përfundime dhe rekomandime

1. Qytetarët kanë një sërë mjetesh ligjore në dispozicion për të qënë pjesë e vendimarrjes në qeverisjen lokale.
2. Iniciativa qytetare është një prej tyre, me anë të cilës qytetarët mund të kërkojnë përmirësimin e jetesës në bashkinë ku ndodhen.
3. Deri më tani nga kërkimi në faqen zyrtare nuk ka asnjë të dhënë për numrin e iniciativave.
4. Kjo vjen si pasojë e mungesës për një kohë të gjatë rregullimeve ligjore mbi procedurën që duhej ndjekur. Shumica e bashkive kanë miratua rregullore të posaçme mbi iniciativën qytetare vetëm në vitin 2020, kur këtë detyrim e kanë patur që prej vitit 2015.
5. Bashkitë, të cilat kanë rregullore të posaçme për iniciativat qytetare, i kanë ato të ngjashme me njëra tjetrën. Bashkitë mund t'i përshtasin ato sipas nevojave të qytetarëve.
6. Bashkia dhe Qarku kanë rolin më të rëndësishëm për të informuar dhe të inkurajuar qytetarët për ndërmarrjen e sa më shumë iniciativave qytetare.
7. Qytetarët duhet të mbajnë parasysh se iniciativa është mjet më i rëndësishëm të cilin mund ta vendosin në lëvizje për çështje të interesit të lartë të komunitetit.
8. Çështjet që qytetarët mund të ngrenë janë çështjet që lidhen bashkinë ku ata banojnë.
9. Procedura për një iniciativë qytetare ndahet në 3 faza keysore: Hartimi i iniciativës nëpërmjet përfaqësuesve, mbledhja e nënshkrimeve dhe depozitimi të saj pranë këshillin bashkiak.
10. Iniciativa duhet të përmbushi kriteret ligjore përsa i përket formatit. Ajo duhet të ketë formën e një akti normativ.
11. Nismëtarët duhet që të bëjnë kërkim të detajuar në lidhje me çështjen që duan të ndryshojnë.
12. Gjuha e përdorur duhet të jetë e thjeshtë dhe e saktë. Fjalitë duhet të jenë të shkurtra.
13. Dokumentat shoqërues të iniciativës, në momentin e dorëzimit, janë relacioni dhe efektet financiare, të cilat depozitohen sëbashku.

Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2. Ligji 135/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”
3. Ligji nr. 9880/2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar;
4. Ligji nr.10273/2010 “Për dokumentin elektronik”, i ndryshuar;
5. Ligji nr. 10325/2010 “Për bazat e të dhënave shtetërore”;
6. Ligji nr.107/2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar.
7. Rregullore e Këshillit Bashkiak “Paraqitja dhe Shqyrtimi i Ankesave, Vërejtjeve, Kërkesave, Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare”, Bashkia Dibër
8. Manual për Hartimin e Legjislacionit
9. Parime dhe rregulla për hartimin e akteve normative, S.Berberi

